



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Gjykimin e çështjes penale që i përket procedimit penal nr. 9, të vitit 2023”, të pandehur **Behar Brajoviq, Edmond Preka, Astmer Bilali, Oltian Bistri dhe Xhevahir Lita**.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtaret Etleva Deda, Irena Gjoka dhe Flora Hajredinaj, me vendimin nr. 73, datë **18.11.2025** vendosi:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Behar Brajoviq, për kryerjen e veprës penale “*Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje*”, në dëm të shtetasit K.M, kryer në bashkëpunim, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal dhe në bazë të neneve 80, 28 pika 4 dhe 334 pika 1 të Kodit Penal dënimin e tij **me 9 (nëntë) vjet burgim**.

1.1-Deklarimin fajtor të të pandehurit Behar Brajoviq, për kryerjen e veprës penale “*Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje*”, në dëm të shtetasve D.D, G.T dhe I.L, kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal dhe në bazë të neneve 80, 28 pika 4 dhe 334 pika 1 të Kodit Penal, dënimin e tij me **10 (dhjetë) vjet burgim**.

1.2-Deklarimin fajtor të të pandehurit Behar Brajoviq për kryerjen e veprës penale “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit*”, kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 278 paragrafi 1, 28 pika 4, dhe 334 pika 1 të Kodit Penal, dënimin e tij me **11 (njëmbëdhjetë) vjet burgim**.

1.3-Deklarimin fajtor të të pandehurit Behar Brajoviq, për kryerjen e veprës penale “*Grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 333/a paragrafi 1, të Kodit Penal dhe dënimin e tij **me 5 (pesë) vjet burgim**.

1.4-Deklarimin fajtor të të pandehurit Behar Brajoviq, për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni aktiv i gjyqtarëve, prokurorëve, dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë*”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319 dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 (dy) vjet burgim**.

1.5-Në bashkim të dënimeve, bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, i pandehuri **Behar Brajoviq** dënohet me një dënim të vetëm, **me 13 (trembëdhjetë) vjet burgim**.

1.6-Në zbatim të nenit 406, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Behar Brajoviq** i ulet 1/3 e dënimit të dhënë, dhe përfundimisht dënohet me **8 (tetë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim**.

1.7-Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Behar Brajoviq** fillon nga data e ekzekutimit të masës së sigurimit “*Arrest në burg*”, dhe të kryhet në një burg të sigurisë së lartë.

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Edmond Preka**, për kryerjen e veprës penale “*Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje*”, në dëm të shtetasit K.M, kryer në bashkëpunim, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 80, 28 pika 4 dhe 334 pika 1 të Kodit Penal, dënimin e tij **me 8 (tetë) vjet burgim**.

2.1-Deklarimin fajtor të të pandehurit **Edmond Preka** për kryerjen e veprës penale “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit*”, kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 278 paragrafi 1, 28 pika 4 dhe 334 pika 1 të Kodit Penal, dënimin e tij **me 10 (dhjetë) vjet burgim**.

2.2-Deklarimin fajtor të të pandehurit **Edmond Preka**, për kryerjen e veprës penale “*Grup i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 333/a paragrafi 2, të Kodit Penal dhe dënimin e tij **me 3 (tre) vite burgim**.

2.3-Në bashkim të dënimeve, bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, i pandehuri **Edmond Preka** dënohet me një dënim të vetëm, **me 10 (dhjetë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim**.

2.4-Në zbatim të nenit 406, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Edmond Preka** i ulet 1/3 e dënimit të dhënë, dhe përfundimisht dënohet me **7(shtatë) vjet burgim**.

2.5-Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Edmond Preka** fillon nga data e ekzekutimit të masës së sigurimit “*Arrest në burg*”, dhe të kryhet në një burg të sigurisë së lartë.

3. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Astmer Bilali**, për kryerjen e veprës penale “*Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje*”, kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetasve D.D, G.T dhe I.L, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 80, 28 pika 4 dhe 334 pika1 të Kodit Penal, dënimin e tij **me 8 (tetë) vjet burgim**.

3.1-Deklarimin fajtor të të pandehurit **Astmer Bilali**, për kryerjen e veprës penale “*Grup i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 333/a, paragrafi 2 të Kodit Penal dhe dënimin e tij **me 3 (tre) vjet burgim**.

3.2-Në bashkim të dënimeve, bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, i pandehuri **Astmer Bilali** dënohet me një dënim të vetëm, **me 8(tetë) vjet e 6(gjashtë) muaj burgim**.

3.3-Në zbatim të nenit 406, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit Astmer Bilali i ulet 1/3 e dënimit të dhënë, dhe përfundimisht dënohet me 5(pesë) vjet e 8(tetë) muaj burgim.

3.4-Vuajtja e dënimit për të pandehurin Astmer Bilali fillon nga data e ekzekutimit të masës së sigurimit “Arrest në burg”, dhe të kryhet në një burg të sigurisë së lartë.

4. Deklarimin fajtor të të pandehurit Xhevahir Lita, për kryerjen e veprës penale “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”, parashikuar nenit 295/a paragrafi 3, të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.

4.1-Deklarimin fajtor të të pandehurit Xhevahir Lita, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, (në lidhje me faktin që lidhet me procedimin e dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Shkodër, ndaj shtetasit Behar Brajoviq etj), parashikuar nga neni 319/ç të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 (katër) vjet burgim.

4.2-Deklarimin fajtor të të pandehurit Xhevahir Lita, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, (në lidhje me faktin penal që lidhet me procedimin penal nr.193/2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Shkodër), parashikuar nga neni 319/ç të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 (katër) vjet burgim.

4.3-Në bashkim të dënimeve, bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, i pandehuri Xhevahir Lita dënohet me një dënim të vetëm, me 5 (pesë) vjet burgim.

4.4 -Në zbatim të nenit 406, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit Xhevahir Lita i ulet 1/3 e dënimit të dhënë, dhe përfundimisht dënohet me 3(tre) vjet e 4(katër) muaj burgim.

4.5- Shuarjen e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, caktuar ndaj të pandehurit Xhevahir Lita me vendimin nr.94, datë 23.007.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4.6-Urdhërohet lirimi i të pandehurit Xhevahir Lita nga ambientet e paraburgimit, nëse nuk mbahet në to në zbatim të ndonjë vendimi tjetër penal, për shkak se pjesa e vuajtur është më e madhe dënimi i caktuar.

5. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Oltian Bistri, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 të Kodit Penal, bazuar në nenin 338 pika 1 shkronja “b”, pasi fakti nuk përbën vepër penale.

5.1-Deklarimin fajtor të të pandehurit Oltian Bistri, për kryerjen e veprës penale “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”, parashikuar nga neni 295/a paragrafi 2 të Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.

5.2-Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Oltian Bistri, për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të

parashikuar nga neni 287/1 shkronja “b” të Kodit Penal, bazuar në nenin 338 pika 1 shkronja “b”, pasi fakti nuk provohet se ekziston.

5.3-Në zbatim të nenit 406, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Oltian Bistri** i ulet 1/3 e dënimit të dhënë, dhe përfundimisht dënohet me **2(dy) vjet burgim**.

5.4- Shuarjen e masës së sigurimit personal “*Arresti në burg*”, caktuar ndaj të pandehurit Oltian Bistri me vendimin nr.94, datë 23.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

5.5- Urdhërohet lirimi i të pandehurit **Oltian Bistri** nga ambientet e paraburgimit, nëse nuk mbahet në to në zbatim të ndonjë vendimi tjetër penal, për shkak se pjesa e vuajtur është më e madhe dënimi i caktuar.

6. Në lidhje me provat materiale, bazuar në nenin 190 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata disponon si më poshtë:

-Provat materiale sekuestruar të pandehurve Pëllumb Gjoka, Behar Brajoviq, Edmond Preka, Ardrit Hasanbegaj, të mbeten pjesë e procedimit penal/çështjes penale të ndarë.

-**Për të pandehurin Astmer Bilali**, bazuar në nenin 190 të kodit të Procedurës Penale provat materiale si më poshtë: *DVR e markës HIKVISION model DS-2708HUHI-K1 me numër serial ****;* *DVR e markës HIKVISION model DS-7208HUHI-M1/S/A me numër serial ****;* *Ipad-Iphone model A2602 me numër serial ****;* *Dy baza karikimi për radio model CH5 të markës BOAFENG;* *Paruke në dukje ngjyrë rozë;* *Kamera kurth me ngjyrë në dukje kamuflazh në pjesën e përparme dhe pjesa e pasme në dukje ngjyrë e zezë e cila ka një kartë memorie të markës Advance Media 32GB ku në pjesën e pasme ka të shënuar ****,* të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit

-**Për të pandehurin Xhevahir Lita**, bazuar në nenin 190 të kodit të Procedurës Penale, provat materiale si më poshtë: *Pistoletë Glock me Nr Serie ****;* *krëhër Rezerve;* *kuti Plastike Vegla Pastrimi;* *fishëk 9x19mm 59 copë;* *autorizim për mbajtje arme zjarri;* *dhe 1 telefon i markës Iphone 14 Pro Max me Nr. IMEI ****,* të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit.

-**Për të pandehurin Oltian Bistri**, bazuar në nenin 190 të kodit të Procedurës Penale provat materiale si më poshtë: *Një USB ngjyrë të zezë me numër serie ****;* *një kuti për aparat telefonik Iphone me numër IMEI ****;* *Një iphone me ngjyrë të zezë në gjendje të ndezur i cili ka të vendosur një kartë SIM me numër serial ****;* *Një iphone me ngjyrë violë në gjendje të fikur brenda së cilës ka një kartë SIM me Nr. ****,* ti kthehen të pandehurit.

-Rrëzimin e kërkesës për konfiskimin e pasurive: *230,000 euro; 200,000 euro; 50,300 euro, 320,000 euro dhe 200,000 euro, në total 1,000,300 (një milion e treqind euro), shuma të cilat janë depozituar në AAPSK; Sipërfaqe ndërtimore e llojit apartamenti ndodhur në katin e ****, shkalla ****, me sipërfaqe totale 400m2, e fituar me kontratën e sipërmarrjes Nr. **** KOI ****, datë 09.03.2019 e porositur*

*nga shtetasi D.I.B; Sipërfaqe ndërtimore e llojit apartament i ndodhur në katin e *****, shkalla *****, me sipërfaqe totale 400m2 e fituar me kontratën e sipërmarrjes Nr. **** Rep , NR.**** Kol datë 09.03.2019, e porositur nga shtetasi E.D.B; Sipërfaqe ndërtimore e llojit njësi dyqan, me sipërfaqe totale 125 m2, e fituar me kontratën e sipërmarrjes Nr.**** Rep , Nr.**** Kol, datë 11.07.2017, e porositur nga shtetasi E.D.B; Sipërfaqe ndërtimore e llojit njësi dyqan, me sipërfaqe 95 m2, e fituar me kontratën e sipërmarrjes Nr.**** Rep, Nr.**** Kol datë 11.07.2017, e porositur nga shtetasja N.T.B; Sipërfaqe Ndërtimore e llojit apartament i ndodhur në katin e **** me sipërfaqe totale 110.6 m2 e fituar me kontratën e sipërmarrjes Nr.**** Rep , Nr.**** Kol, datë 25.02.2019, e porositur nga shtetasi Oltian D. Bistri, si të pabazuar në ligj e prova.*

7. Shpenzimet procedurale të kryera gjatë fazës së hetimit paraprak, seancës paraprake dhe gjatë gjykimit, sipas procesverbalit bashkëlidhur këtij vendimi, u ngarkohen të pandehurve të këtij gjykimi dhe bashkëpandehurve të tjerë, të këtij procedimi penal, ne mënyrë solidare.

8. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga njoftimi i vendimit të arsyetuar.

Tiranë, më datë 19.11.2025

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar